



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:022440
Datë: 18.11.2024
Numri i dokumentit: 06464734

C.nr.202/2020

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI, gjyqtari Arben Xheladini, në çështjen juridike kontestimore të paditësit/kundër të paditurit, I.B., Vitia Rr. “Adem Jashari”, i përfaqësuar me autorizim nga E.P., avokat në Viti, kundër të paditurve M.S., Z.S.dhe V.K., të cilët me autorizim i përfaqëson Z.S.nga Kllokoti, të paditurve/kundër paditësve S.B. dhe F.B., të përfaqësuar me autorizim LE.avokat në Viti, të paditurve T.B., M.B.nga fshati R., Komuna e Vitisë, me vendqëndrim në Gjermani përkatësisht Francë, të paditurës G. N.B.nga Ferizaj, Rr. “Luigj Gurakuqi” p.nr., e përfaqësuar nga S.B., dhe të paditurit/kundër paditësit, N.B.nga Vitia, Rr. “Adem Jashari” p.nr., me objekt kontesti vërtetimi i pronësisë, vlera e kontestit 9000 Euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe publik më datë 04.10.2024, jashtë seancës mori dhe më datë 29.10.2024¹, përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I. Miratohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësit/kundër të paditurit, I.B., vërtetohet se paditësi është pronar i ngastrës 381-0 me sipërfaqe 470 m²; ngastrës 380-0 me sipërfaqe 450 m²; dhe 382-0, me sipërfaqe 420 m², të gjitha në vendin në vendin “R.-Dvorishte” ZK R..

II. Refuzohet e pathemeltë kërkesëpadia e paditësit, I.B. me të cilën ka kërkuar të vërtetohet se është pronar i ngastrës 379-0 me sipërfaqe 550 m² ne vendin “R. Dvorishte” ZK R..

III. Refuzohet e pathemeltë kërkesëpadia e kundër paditësit/të paditurit N.B.e paraqitur ndaj paditësit / të kundër paditurit, I.B., me të cilën ka kërkuar të vërtetohet se është pronar i ngastrës 379-0 në vendin “R.-Dvorishte” me sipërfaqe 550 m² ZK R..

IV. Refuzohet e pathemeltë kërkesëpadia e kundër paditësve/të paditurve, S.B. dhe F.B. e paraqitur ndaj paditësit/të kundër paditurit, I.B., me të cilën kanë kërkuar të vërtetohet se janë pronar të sipërfaqes prej 147 m² në kuadër të ngastrës 382-0 me sipërfaqe të përgjithshme 420 m², në vendin “RR.-oborr”, që në anën veriore kufizohet me parcelën 378-1 në gjatësi 3.17 m, në anën lindore me parcelën 383-0 në gjatësi 37.33, në anën jugore me parcelën 388-0 në gjatësi 4.64 dhe në anën perëndimore me vetë parcelën 382-0 në gjatësi nga pika 1 deri në pikën 4 në gjatësi 1.77 m, nga pika 1 deri te pika 2 në gjatësi 13.69 m, nga pika 2 deri te pika 3 në gjatësi 23.43 m.

V. Konstatohet e tërhequr padia e paditësit, I.B., kundër të paditurve, T.B., G. N.B.dhe M.B..

VI. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës, ndërsa, detyrohet paditësi/i kundërpadituri I.B., që përfaqësuesit të përkohshëm, L.E., avokat në Viti, t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 507 Euro.

¹ Kryetari i Gjykatës është njoftuar për vonesën në përpilimin e aktykimit me kohë.

Arsyetim

Historiku procedural

Sipas shkresave të lëndës, me aktgjykimin C.nr. 16/06, të datës 26.03.2007, të Gjykatës së atëhershme Komunale të Vitisë, është miratuar kërkesëpadia e paditësit Z.B., kundër të paditurve; S.S., N.S.dhe V.S., lidhur me ngastrat: 379-0, 380-0, 381-0, 382-0, të gjitha në vendin në vendin “R.-Dvorishte” ZK R.. Meqë nuk kishte pasur ankesë nga përfaqësuesi i përkohshëm në atë kohë, aktgjykimi kishte marrë formë të prerë, për t’u anuluar pastaj² me aktvendimin procedural të datës 29.12.209³, pas miratimit të kërkesës për përsëritje të procedurës të paraqitur nga përfaqësuesi i përkohshëm.

Pastaj, N.B.dhe S.B.më datë 09.09.2009 kishin ngreh padi kundër të paditurit Z.B.t, lënda ishte evidentuar me numrin C.nr. 305/2009, objekt kontesti sipas kësaj padie ishin ngastrat: 379-0 me sipërfaqe 550 m² të cilën e pretendonte N.B. dhe, 382-0 me sipërfaqe 420 m² të cilën e pretendonte S.B., me arsyetimin se ishin blerë që nga vitet e ’70, ashtu që gjykata i kishte bashkuar lëndët me numër C.nr. 16/16 dhe 305/2009, procedimi i çështjes kishte vazhduar me numrin C.nr. 16/2016.

Pretendimet e paditësit/të kundër paditurit, Z.B. ishin të njëjta për të gjitha ngastrat objekt i kontestit sipas padisë së tij, ndërsa, i padituri/kundër paditësi, N.B.kishte pretenduar se ngastrën 379-0 e kishte blerë në vitin 1965, dhe nga ajo kohë e kishte shfrytëzuar i pa penguar. I padituri/kundër paditësi S.B., kishte kërkuar të vërtetohet se është pronar i ngastrës 380-0 me sipërfaqe 420 m² me arsyetimin se e kishte blerë, për ta ndryshuar pastaj duke e kërkuar në bazë përkufizimeve që do të caktoheshin përmes ekspertizës së gjeodezisë sipas gjendjes faktike të shfrytëzuar. Me aktgjykimin C.nr. 16/2006, të datës 24.10.2011 gjykata kishte vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësit Z.B.t dhe kundërkërkesat e Nexhat e S.B.t.

Po ashtu, sipas shkresave, rezulton se aktgjykimi C.nr.16/2006, i datës 24.10.2011 ishte prishë dhe lënda ishte kthyer në rivendosje nga Gjykata e atëhershme e Qarkut në Gjilan me Aktvendimin C.nr. 6/2012, të datës 08.05.2012. Pastaj, gjykata kishte vendosur me aktgjykimin C.nr. 141/2012, i datës 28.05.2014, e të cilin e kishte anuluar Gjykata e Apelit me aktvendimin AC.nr. 3639/14, të datës 23.12.2019.

Pas kthimit të lëndës në rivendosje, me aktvendimin e datës 20.12.2021, gjykata e ka ndërprerë procedurën për shkak të vdekjes së të paditurit/kundër paditësit, S.B.. Meqë paditësi Z.B. kishte vdekur në vitin 2015, si marrës përsipër i procedurës është paraqitur I.B., i cili me parashtrësën e datës 14.11.2023 ka kërkuar që gjykata t’i ftoj trashëgimtarët e S.B.t: S.B.n, F.B.n, T.B.n, M.B.n dhe G. B.in, për ta marrë përsipër procedurën, në të kundërtën të konsiderohen të paditur.

Sipas propozimit të paditësit/të kundër paditurit I.B., gjykata e ka caktuar avokatin L.E. përfaqësues të përkohshëm të të paditurve, T.B. dhe M.B.pasi në seancën e datës 04.03.2024, e paditura/kundër paditësja S.B. ka deklaruar se të dy këta jetojnë jashtë shtetit⁴. Në seancën e datës 23.09.2024, S.B. e ka dorëzuar autorizimin për ta përfaqësuar T.B.n, e që paraprakisht e ka pasur autorizimin për përfaqësim të F.B.t dhe G. Nuredini B.it. Pastaj, përfaqësuesi paditësit/të kundër paditurit, I.B. e ka tërhequr padinë kundër T.B.t, M.B.t dhe G. Nuredini B.it, e meqë përfaqësuesit e tyre nuk e kanë kundërshtuar tërheqjen e padisë, gjykata, me aktvendim procedural e ka konstatuar të tërhequr padinë, ashtu që përfaqësuesit të përkohshëm i kanë pushuar autorizimet sipas ligjit, dhe shqyrtimi ka vazhduar me palët tjera ndërgjyqëse.

² Nga gjyqtari i shkallës së parë që kishte vendosur në atë kohë.

³ Pastaj më datë 25.01.2010 kishte nxjerrë aktvendim të vecantë, i formës së prerë nga data 12.02.2010

⁴ Taulant Beqiri në Gjermani, ndërsa Marigona Beqiri në Francë.

Pas plotësimit të kushteve ligjore për procedimin e kësaj çështje⁵, përfaqësuesi i paditësit/ të kundër paditurit, I.B., në seancën përgatitore, shqyrtim kryesor të çështjes dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësit ta miratohet e bazuar, duke propozuar që gjykata t'ia njeh paditësit të drejtën e pronësisë në ngastrat kadastrale 379-0, me sipërfaqe 550 m², në ngastrën 380 me sipërfaqe 450 m², në ngastrën 381-0 me sipërfaqe 470 m² dhe ngastrën 382-0 me sipërfaqe 420 m² të gjitha në vendin "R.-oborr" ZK R.. Ka pretenduar se pas administrimit të provave materiale, sidomos deklaratës së Bademe Zekes, është vërtetuar se paluajtshmëritë që A.Z.i kishte blerë nga Nedelko, Vida dhe S.S., në vitin 1970 ia kishte shitur Z.B.t.

Ka propozuar që kundërkërkesat e të paditurve/kundër paditësve, N.B., S.B. dhe F.B. gjykata t'i refuzoj të pabazuara meqë nuk është vërtetuar pretendimi i shitblerjes së tyre apo pjesëve të tyre.

Përfaqësuesi me autorizim i të paditurve, M.S., Z.S.dhe V.K., nuk e ka kundërshtuar kërkesëpadinë asnjërit prej palëve ndërgjyqëse në këtë kontest duke shtuar se ka autorizim të deklarohet se ngastrat kontestuese i kishte blerë Ali Zeka, i cili më vonë i kishte shitur, mirëpo nuk kishte njohuri se cilit person. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e ka asnjë kundërshtim dhe do ta pranoj çfarëdo vendimi të gjykatës.

I padituri/kundër paditësi, N.B.në padinë e dorëzuar më datë 09.09.2009 ka pretenduar se është në posedim dhe shfrytëzim faktik të ngastrës 379-0 me sipërfaqe 550 m² ZK R., se personalisht në vitin 1965 e kishte blerë dhe nga ajo kohë nuk ishte penguar nga askush. Në seancën përgatitore ka deklaruar se ngastra 379-0 është pronë e familjes së tij qe 50 vjet, të cilën e kishte blerë vëllai i tij, Z. V.B. në vitin 1970 apo 1972 në Maqedoni, nga një serb i quajtur Simiq apo Rade. Ka pretenduar se Z.B., me lejen H.B.dhe të R.B., nga A.Z.i kishte blerë ngastrat 380-0 dhe 381-0. Se në njërën prej këtyre dy ngastrave kishte qenë e ndërtuar një shtëpi, e pastaj në vitin 1980 Z.B. e kishte ndërtuar një shtëpi tjetër, dhe e kishte kufizuar pjesën e sipërfaqes së tij me mure që ende ekzistojnë. Se Z.B. kurrë nuk e kishte shfrytëzuar parcelën 379-0, e po ashtu as pjesën e parcelës në anën e S.B.t. Për këto arsye e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit/të kundër paditurit, I.B. vetëm për ngastrën 379-0 dhe ka kërkuar nga gjykata që këtë pjesë të kërkesëpadiës së paditësit/të kundër paditurit I.B. ta refuzoj të pabazuar. Këto pretendime i ka përsëritur edhe në fjalën përfundimtare me pretendimin se me deklaratat e dëshmitarëve të tij, i ka vërtetuar pretendimet sipas padisë dhe ka kërkuar që gjykata t'ia miratoj kërkesëpadinë e paraqitur kundër paditësit/të kundër paditurit I.B.t dhe të vërtetoj se i padituri/kundër paditësit N.B.në bazë të mbajtjes është pronar i ngastrës 379-0, me sipërfaqe 550 m² ZK R..

Të paditurit/kundër paditësit S.B. dhe F.B.⁶ në seancën përgatitore kanë deklaruar se me paditësin/të kundër paditurin, I.B., kufirin e kanë të ndarë me muri që Z.B. vetë e kishte ndërtuar. E kanë kundërshtuar pjesën e kërkesëpadiës së paditësit/të kundër paditurit, I.B., për sipërfaqen e tokës së ngastrës 0382-0 që S.B., e kishte pasur në posedim. Nuk e kanë propozuar asnjë provë materiale dhe/ose personale për të mbështetur pretendimet. Ndërsa, përmes përfaqësuesit të tyre me autorizim, Av. L.E.⁷, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare kanë pretenduar se nga administrimi i provave materiale është vërtetuar se S.B., përkatësisht, tani të paditurit/kundër paditësit, S.B. dhe F.B., është vërtetuar se janë në shfrytëzim faktit të pjesës së sipërfaqes prej 147 m² të ngastrës 382-0, në vendin "R.-Dvorishte" ZK R., dhe kanë kërkuar që gjykata kërkesëpadinë e tyre ta miratoj dhe të vërtetoj se janë pronarë të sipërfaqes prej 147 m² në kuadër të ngastrës 382-0 me sipërfaqe të përgjithshme 420 m², që në anën veriore kufizohet me

⁵ Në seancën e datës 04.03.2024 përfaqësuesi i paditësit ka propozuar dërgimin e lëndës në ndërmjetësim, por për shkak të mospranimit të pëlqimeve nga të gjithë palët, gjykata e ka vazhduar procedurën.

⁶ Bashkëshorte përkatësisht djali i Sherif Beqirit.

⁷ Që i ka përfaqësuar vetëm në seancën e fundit.

parcelën 378-1 në gjatësi 3.17 m, në anën lindore me parcelën 383-0 në gjatësi 37.33, në anën jugore me parcelën 388-0 në gjatësi 4.64 dhe në anën perëndimore me vetë parcelën 382-0 në gjatësi nga pika 1 deri në pikën 4 në gjatësi 1.77 m, nga pika 1 deri te pika 2 në gjatësi 13.69 m, nga pika 2 deri te pika 3 në gjatësi 23.43 m. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për një seancë në shumë prej 202.80 Euro.

Për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë pretendimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike, gjykata, sipas propozimit të paditësit/të kundër paditurit I.B., i ka administruar: tri certifikata pronësore të datës 23.01.2006 për ngastrat 379-0, 380-0, 381-0, 382-0, e ka lexuar deklaratën e B.Z. të datës 21.01.2010 dhe e ka siguruar provën me ekspertizë të gjeodezisë, ndërsa sipas propozimit të të paditurit/kundër paditësit, N.B., e ka lexuar deklaratën e dëshmitarit V.B.- nga procesverbali i datës 29.12.2009, dhe i ka dëgjuar dëshmitarët M.Z. dhe Z. V.B. në rrethanat e propozuara.

Pas administrimit të të gjitha provave materiale një nga një dhe të gjithave së bashku, sipas nenit 8 të LPK-së, për arsyet e mëposhtme, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Seanca e vend-shikimit

Më datë 07.08.2024, gjykata e ka mbajtur seancën e vend-shikimit, në të cilën kanë prezantuar palët ndërgjyqëse me përfaqësuesit e tyre dhe eksperti gjeodet, T.N.. Ngastra 379-0, nuk ishte e punuar e as e mirëmbajtur, në anën perëndimore dhe veriore nuk kishte kufij të dukshëm faktik. Në pjesën lart të ngastrës 380-0/në anën veriore ishte e ndërtuar një shtëpi e vjetër P+0, pjesërisht e dëmtuar dhe nuk ishte e banueshme, ndërsa, në anën perëndimore ishte një “kosh i vjetër” dhe ngjitas me të një hapësirë tjetër e ndarë me mbulojë. Ndërmjet ngastrës 380-0 dhe 381-0 nuk kishte kufij të dukshëm faktik, e po ashtu nuk vëreheshin kufij të dukshëm faktik as në anën veriore të tyre. Në anën jugore të ngastrës 381-0 ishte një pus me kapak betoni, nga pusi në një largësi prej rreth 15 metrash ishte një muri i vjetër me gurë që shtrihej në jug-veri, pjesërisht i dëmtuar, e në skaj të murit kishte pemë të ndryshme. Të gjitha ngastrat kontestuese kufizoheshin me rrugën publike të fshatit, e po ashtu në kufi me rrugën ngastrat 380-0, 381-0 dhe 382 ishin të rrethuara me muri të vjetër, të cilin e ndanin dyert e mëdha të drurit (shihej që ishin të vjetra) dhe një derë e posaçme (e dëmtuar) për të hyrë në këto tri ngastra. Një pjesë e ngastrës 380-2 ishte jashtë murit rrethues së ndërtuar nga paditësi/i kundër padituri I.B., e kjo sipërfaqe dukej se ishte e bashkuar me parcelën tjetër, jo objekt i këtij shqyrtimit, që në seancën e vend shikimit e paditura/ kundër paditësja S.B. ka deklaruar se është pjesë e kërkesëpadisë së saj. Nga eksperti gjeodet është kërkuar që në konstatimin e tij me shkrim të paraqes gjendjen faktike të të gjitha ngastrave, duke paraqitur përkufizimet e pjesës së sipërfaqes së identifikuar nga e paditura/kundër paditësja S.B..

Eksperti gjeodet është dëgjuar në seancën e shqyrtimit kryesor dhe lidhur me vërejtjen e të paditurit/ kundër paditësit, N.B., ka sqaruar se para dorëzimit të ekspertizës në Zyrën e Komunale Kadastrale në Viti e ka vërtetuar faktin se pronar i regjistruar i të gjitha ngastrave kontestuese, në ditën e dorëzimit të ekspertizës - më datë 02.09.2024, ka qenë I.B..

Përmbledhje e deklaratave të dëshmitarëve.

Dëshmitari M.Z. në seancën e shqyrtimit kryesor, ndër të tjera, ka deklaruar se i padituri/kundër paditësi, N.B., nga viti 1974 e kishte pasur në posedim Lamen (vj. ngastrën 379-0) ku e kishte mbajtur ushqimin e kafshëve, as Z.⁸ e as paditësi/ i kundër padituri, I.B., nuk kanë pasur problem e as nuk ia kanë kontestuar, kjo ngastër është e ndarë me muri që ende është ekzistues. Nuk ka

⁸ Paditësi që e ka inicuar procesin kontestimor në vitin 2006.

qëndruar në deklaratën e mëhershme me arsyetimin se Z. e kishte mashtruar, pasi ka menduar se ka dhënë deklaratë vetëm për tokën që Z. e ka pasur të rrethuar me muri dhe ku e ka pasur të ndërtuar shtëpinë dhe se nuk kishte qenë në dijeni se me padi e ka kërkuar edhe tokën që është jashtë mureve, duke shtuar se deklarimin e mëhershëm e kishte bërë për tokën që Z. e kishte blerë nga një rom dhe që e ka pasur të kufizuar me muri. Se tokën-Lamën e kishte blerë Miam B.i/vëllai i N.B.t dhe këtë fakt ia kishte treguar Z. V.B.dhe Z. B.i.

Dëshmitari, Z. B.i, në seancën e shqyrtimit kryesor, ndër të tjera ka deklaruar se qe 50 vjet prej Devajës janë vendosur për të jetuar në R., e për për arën “Lamën” para shtëpisë nuk kishin pasur problem as me Z.B.n e as me ndonjë person tjetër. Se këtë arë, nuk i kujtohej viti, personalisht kishte shkuar në Maqedoni dhe e kishte blerë prej atyre që e kanë pasur-nga një grua, emri i të cilës nuk i kujtohej, duke shtuar se në atë kohë kishte qenë moshës rreth 60 vjeçare. Se në një letër të thjeshtë e kishin shënuar marrëveshjen për tokën e blerë dhe çmimin, e cila i kishte humbur gjatë kohës së luftës. Nuk kishte njohuri se në cilin vit A.Z.ishte vendosur për të jetuar në fshatin R., ndërsa, për S.B.n ka pohuar të jetë vendosur në fshatin R. para Zenel dhe I.B.t. Dëshmitari ka shtuar se për këtë tokë nuk është interesuar e as nuk është i interesuar, e sipas tij kjo tokë nuk i duhet as N. e as Ibushit. Se këtë tokë e kishin shfrytëzuar gjatë kohës sa kishin qenë në fshat-kishin vendosur ushqimin e kafshëve, drutë etj.

Dëshmitari Vebi B.i⁹, 62 vjeç në kohën e dhënies së deklaratës, në procesverbalin e datës 29.12.2009, kishte deklaruar se në vitin 1970 Z.B. e kishte blerë pronën kontestuese nga Ali Zeka, kishte hyrë në posedim dhe e kishte shfrytëzuar i pa penguar aty ku e ka shtëpinë dhe përpara e deri te S.B.ku është kufiri. Se ngastrën prapa shtëpisë (vj. ngastrën 379-0) nuk e kishte shfrytëzuar Z., por N.B.në të cilën e kishte mbajtur ushqimin e kafshëve, duke shtuar se citim: *“nëse më pytni i kujna është ai vend, unë nuk e di”*, e po ashtu kishte deklaruar se një ditë para seancës (së datës 29.12.2009), N. dhe Z. V.B.kishin kërkuar nga ai të deklaronte se “Lama” është e N.. Pastaj dëshmitari kishte shtuar se në mes Z.t dhe S. është një muri i ndërtuar para 20 viteve.

Gjatë shqyrtimit kryesor të çështjes, gjykata ka vërtetuar se kontesti ndërmjet palëve ndërgjyqëse ndërlidhet me atë nëse Z.B., baba i paditësit/ të kundër paditurit, I.B. e kishte blerë dhe pasur ndonjëherë në posedim ngastrën 379-0 që i referoheshin si “Lama”, dhe sipërfaqen prej 147 m² të ngastrës 382-0 me përkufizime si në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit.

Për ngastrën 379-0 i padituri / kundër paditësi N.B.me padinë e datës 09.09.2009 ka pretenduar ta ketë blerë personalisht në vitin 1965, për ta ndryshuar pastaj se këtë parcelë në vitin 1970/72 e kishte blerë vëllai i tij, Z. B.i, nga një serb i quajtur Simiq apo Rade. Për pjesën e sipërfaqes 147 m² të ngastrës 382-0, të paditurit/kundër paditësit, S.B. dhe F.B. pretendonin se e kishin në posedim të qetë dhe të pa penguar nga askush.

Nga administrimi i provave materiale, certifikatat e datës 23.01.2006 gjykata ka vërtetuar se ngastra 379-0 me sipërfaqe të përgjithshme 550 m² (40 m² shtëpi-ndërtesë, 500 m² oborr dhe 10 m² arë) në vendin “R. Dvorishte” ZK R. ka qenë e evidentuar në emër të V.S.¹⁰; ngastra 380-0 me sipërfaqe të përgjithshme 450 m² (18 m² shtëpi-ndërtesë dhe 432 m² oborr) dhe ngastra 382-0 me sipërfaqe 420 m², të dyja në vendin “R. Dvorishte” ZK R. kanë qenë të evidentuara në emër të Simiq (Cvetka) Nedeljko, dhe ngastra me numër 381-0 me sipërfaqe 470 m² në vendin “R. Dvorishte” ZK R., ka qenë e evidentuar në emër të Sima (Cvetka) Simiq.

Sipas deklaratës B.Z.të datës 21.01.2010, A.Z.në fillim të viteve ’70-ta, ia kishte shitur Z.B.t nga fshati Devajë, tërë pasurinë e paluajtshme, me sipërfaqe rreth 20 ar, në fshatin R., të cilën, A.Z.e

⁹ Vëlla i paditësit / të kundër paditurit, Zenel Beqiri.

¹⁰ Vida Simiq, e lindur Maksimoviq, e veja e Dragutinit (djalit të Tases).

kishte blerë nga N.S., V.S. dhe S.S.. Para zyrtarit kompetent në Suedi, B.Z.ishte paraqitur bashkëshorte e A.Z.dhe e kishte vërtetuar nënshkrimin e kësaj deklarate.

Nga ekspertiza e ekspertit gjeodet, gjykata ka vërtetuar se:

-Pronar i regjistruar i ngastrave: 379-0, me sipërfaqe 550 m², 380-0 me sipërfaqe 450 m², 381-0 me sipërfaqe 470 m² dhe 382-0 me sipërfaqe 420 m², të gjitha në vendin “Dvorishte R.” ZK R., ishte I.B. tani paditës/i kundër paditur;

-Parcela 379-0, në veri kufizohet me parcelën 378-1 në gjatësi 13.49 m, në lindje me parcelën 381-0 me gjatësi 39.16 m, në jug me rrugën publike “B.i” në gjatësi 15.64 m dhe në perëndim me parcelën 378-1 në gjatësi 34.40 m;

-Parcela 380-0, në veri kufizohet me parcelën 378-1 në gjatësi 9.83 m, në lindje me parcelën 381-0 me gjatësi 42.55 m, në jug me rrugën publike “B.i” në gjatësi 16.43 m dhe në perëndim me parcelën 370-0 në gjatësi 39.16 m;

-Parcela 381-0, në veri kufizohet me parcelën 378-1 në gjatësi 10.45 m, në lindje me parcelën 382-0 me gjatësi 39.48 m, në jug me rrugën publike “B.i” në gjatësi 14.69 m dhe në perëndim me parcelën 380-0 në gjatësi 42.55 m;

-Parcela 382-0, në veri kufizohet me parcelën 378-1 në gjatësi 10.01 m, në lindje me parcelën 383-0 me gjatësi 37.33 m, në jug me rrugën publike “B.i” në gjatësi 4.64 m dhe në perëndim me parcelën 381-0 në gjatësi 39.48 m;

-Parcelën 382-0 e ndanë një muri në dy pjesë në drejtim/shtrirje jug-veri (në skicë i paraqitur me vijë të kuqe nga pika 1, 2, 3 dhe 4) që nga pjesa perëndimore e parcelës deri te muri përfshirë edhe bazën e murit janë 337 m² me dimensione: nga ana veriore me gjatësi 6.84 m, nga ana lindore me gjatësi të përgjithshme 37.89 m, nga ana jugore me gjatësi 10.80 m dhe nga ana perëndimore me gjatësi 39.48 m. Se kjo sipërfaqe është në anën që paditësi/ i kundër padituri e ka në shfrytëzim;

-Ndërsa, nga ana lindore janë 147 m² të parcelës 382-0 me këto përkufizime: nga ana veriore me gjatësi 3.17 m, nga ana lindore me gjatësi 37.33 m, nga ana jugore me gjatësi 4.64 m dhe nga ana perëndimore me gjatësi 37.89 m. Se kjo sipërfaqe është në anën tjetër të murit – të cilën e kërkonin të paditurit/kundër paditësit, S.B. dhe F.B..

Palët ndërgjyqëse nuk kanë pasur vërejtje në konstatimin e ekspertit gjeodet, me përjashtim të të paditurit/ kundër paditësit N.B., vetëm në pjesën e konstatimit se paditësi/i kundër padituri I.B., është pronar i regjistruar i të gjitha parcelave kontestuese. Gjykata ia fali besimin konstatimit të ekspertit gjeodet pasi ekspertizën e ka punuar sipas detyrave të përcaktuara, dhe ka dhënë sqarime se në regjistrin kadastral pronar i të gjitha ngastrave kontestuese është I.B. dhe këtë fakt e kishte verifikuar më Zyrën Komonale Kadastrale në Viti në datën e dorëzimit të ekspertizës në gjykatë-02.09.2024.

Pavarësisht se paditësi/i kundër padituri, I.B., është pronar i regjistruar i të gjitha ngastrave kontestuese, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje duhet të vendoset në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e tij në raport me të gjitha ngastrat kontestuese. Kjo për faktin se aktgjykimi që paraardhësit të tij, Z.B.t, i kishte shërbyer titull juridik për t’u regjistruar pronar i ngastrave kontestuese, nga gjykata e shkallës së dytë është prishë dhe lënda është kthyer në rivendosje. Në kohën e dorëzimit të parashtresës për marrjen përsipër të procedurës, I.B. ka deklaruar se është shpallë trashëgimtar i vetëm i Z.B.t, duke e dorëzuar edhe aktvendimin me të cilin ishte rregulluar

trashëgimia, fakt të cilin asnjë nga të paditurit/kundër paditësit nuk e kanë kundërshtuar, mirëpo, i padituri/kundër paditësi, N.B. me padi ia kontestonte pronësinë në ngastrën 379-0, ndërsa të paditurit/kundër paditësit, S.B. dhe F.B., sipërfaqen prej 147 m² të ngastrës 382-0 me përkufizime si në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit.

Pasi të paditurit/kundër paditësit N.B., S.B., F.B. nuk e kontestonin pjesën e kërkesëpadiisë për ngastrat 380-0 dhe 380-1, e as përfaqësuesi i të paditurve, M.S., Z.S.dhe V.K. nuk e kontestonte kërkesën e paditësit/ të kundër paditurit, I.B., gjykata e miratoi kërkesën e paditësit pjesërisht si në petium të aktgjykimit, për ngastrat 380-0, 381-0. Gjukata e miratoi në tërësi kërkesën e tij edhe për ngastrën 382-0, përkundër faktit që në anën lindore sipërfaqja prej 147 m² e parcelës 382-0 ishte jashtë murit pasi gjatë shqyrtimit, gjykata ka vërtetuar se Z.B. edhe këtë ngastër e kishte blerë nga Ali Zeka, dhe faktin e blerjes së kësaj ngastre, në parim nuk ia kontestonin as të paditurit/kundër paditësit S.B. dhe F.B.. Fakti se pjesën e sipërfaqes prej 147 m³ e kishte jashtë murit rrethues, nuk ishte me ndikim pasi të paditurit/kundër paditësit, S.B. dhe F.B. me asnjë provë materiale dhe/ose personale nuk e kanë vërtetuar pretendimin se këtë sipërfaqe e kanë në posedim me mirëbesim, e po ashtu nëse raportin material e kanë krijuar me pronarin juridik të saj.

Ndërsa, për arsyet e mëposhtme, gjykata i refuzoi të pathemelta kërkesat e kundër paditësve/të paditurve, N.B., S.B. dhe F.B..

Kërkesëpadiinë e të paditurit/ kundër paditësit, N.B., gjykata e refuzoi të pathemeltë pasi me asnjë provë nuk e vërtetoi pretendimin se ngastrën 379-0, e kishte blerë personalisht nga pronari juridik i saj në vitin 1965. Po ashtu, nuk e vërtetoi as pretendimin se këtë ngastër e kishte blerë vëllai i tij Z. V.B.në vitin 1970/1972. Edhe sikur vërtetë këtë ngastër ta kishte blerë vëllai i tij, Z. B.i, i padituri/kundër paditësi, N.B., nuk do të kishte legjitimitet real aktiv meqë nuk e ka krijuar raportin juridik me pronarin e ngastrës, ndërsa, gjatë shqyrtimit kryesor me asnjë provë nuk e vërtetoi se mbi çfarë bazë kjo ngastër i kishte takuar atij, përdërisa në proces nuk është palë edhe Milam V.B.si blerës i pretenduar. Gjukata e ka dëgjuar dëshmitarin Z. B.i, i cili ka deklaruar se këtë ngastër e kishte blerë nga një serbe në Maqedoni, nuk i kujtohej as viti, as emri i shitësit e as çmimi i kontraktuar, por vetëm e ka përshkruar shitësen si një grua në atë kohë 60 vjeçare. Deklaratën e këtij dëshmitari gjykata e ka vlerësuar të parëndësishme pasi nuk i vërtetoi pretendimet e të paditurit/kundër paditësit N.B., e që si palë në këtë kontest, ka qenë kontradiktor në pretendimet e tij, fillimisht duke pretenduar se në vitin 1965 vetë e kishte blerë këtë parcelë, për ta ndryshuar pastaj pretendimin se vëllai i tij, Z. V.B.e kishte blerë atë në vitin 1970 ose 1972, nga një serb, duke deklaruar me hamendësime emrin e shitësit, kohën e raportit material juridik dhe çmimin e kontraktuar.

Gjukata e ka refuzuar të pathemelte kërkesëpadiinë e të paditurve/kundër paditësve, S.B. dhe F.B. pasi me asnjë provë materiale dhe/ose personale nuk e mbështeten pretendimin se sipërfaqen prej 147 m² të ngastrës 382-0 e kanë në posedim, e fakti se kjo sipërfaqe e tokës është jashtë murit rrethues të paditësit/kundër të paditurit, I.B., nuk e legjitimon pretendimin se e kanë fituar pronësinë në këtë pjesë të sipërfaqes së ngastrës. Gjatë shqyrtimit nuk propozuan asnjë provë për të vërtetuar aktin e posedimit të qetë dhe të pa penguar, e as nuk e mbështeten krijimin e raportit juridik material me pronarin e ngastres në atë kohë.

Duke pasur parasysh kohën e krijimit të raportit juridik material, ligj i zbatueshëm është Ligji mbi Themelimin e Marrëdhënieve Juridike Pronësore i 1980 (tutje LMTHJP), përkatësisht në neni 28 të tij, sipas së cilit: “Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh” ndërsa, neni 70 ka përcaktuar: “Posedimin e sendit e ka çdo person që ushtron drejtpërdrejt zotërimin faktik të sendit (posedimi i drejtpërdrejtë)” tutje, neni 72 ka përcaktuar:

“Posedimi është i ligjshëm poqëse mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike që nevojitet për të fituar të drejtën e pronësisë dhe nëse nuk është fituar me forcë, me mashtrim ose me keqpërdorimin e besimit. Posedimi është me mirëbesim poqëse mbajtësi nuk di ose nuk mund të dijë se sendi që e mban nuk është i tij. Mirëbesueshmëria e posedimit supozohet”.

Për ngastrat që ia miratoi kërkesëpadsisë, gjykata ka vlerësuar se paditësi/i kundërpadituri, I.B., e ka mbështetur bazën ligjore të kërkesëpadsisë. Ndërsa, përkundër që kanë pretenduar, të paditurit/kundër paditësit N.B., Shukrije, V.B.dhe F.B. nuk i mbështetën pretendimet e tyre. Kushtet ligjore nga neni 28 i LMTHJP duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, ashtu që dështimi që me prova bindëse t’i vërtetojnë pretendimet lidhur me krijimin e raportit material me pronarët juridikë të ngastrave, për pasojë e ka refuzimin e kërkesës të pathemeltë.

Meqë i padituri/kundër paditësi N.B.me asnjë provë nuk arriti të vërtetoj legjitimitetin real aktiv, edhe deklaratat e dëshmitarëve se ngastrën që e kërkonte me padi, e ka pasur në posedim nuk janë me rëndësi për këtë çështje. Gjykata e ka refuzuar kërkesën e të paditurit/kundër paditësit, N.B.për dëgjimin e dëshmitarit Ilmi Salihu në rrethanat se e kishte ndërtuar murin e paditësit/të kundër paditurit, I.B.t, meqë deklarata e këtij dëshmitari ishte e parëndësishme.

Gjykata e konstatoi të tërhequr padinë e paditësit I.B. kundër të paditurve, T.B., M.B.dhe G. N.B. duke u bazuar në nenin 261, par. 2 i LPK-së pasi nuk u kundërshtua nga përfaqësuesi i tyre.

Për shpenzimet e paditësit/të kundërpaditurit, I.B., të paditurve M.S., Z.S.dhe V.K., dhe të paditurit/kundër paditësit, N.B., gjykata vendosi duke u mbështetur në nenin 450 të LPK-së, sepse nuk i kanë kërkuar ndërsa, për shpenzimet e të paditurve/kundër paditësve S.B. dhe F.B. për faktin se nuk patën sukses në kërkesën e tyre.

Për shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 81.2 dhe 463 të LPK-së pasi është detyrë e paditësit/ të kundër paditurit t’i paguaj këto shpenzime në shumë prej 405 Euro; për dy seanca nga 202 Euro dhe 50% e një seance shumë prej 105 Euro. Paditësi, para fillimit të shqyrtimit, për shpenzimet e përfaqësuesit të përkohshëm, e ka deponuar shumë e të hollave prej 717 Euro nga e cila përfaqësuesit të përkohshëm do t’i bartet shuma prej 405 Euro. Shuma prej 208 Euro e mbetur nga depozita civile, pas plotësimit të kushteve ligjore, do t’i kthehet paditësit.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA VITI
C.nr.202/2020, më datë 29.10.2024

Gjyqtari,

Arben Xheladini

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:022440
Datë: 18.11.2024
Numri i dokumentit: 06464734